



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

***PËR KANDIDATËT APLIKANTË NË TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË SPECIALIZIMEVE
AFATGJATA TË CIKLIT TË TRETË NË FUSHËN E MJEKËSISË DHE STOMATOLOGJISË***

Për të gjithë kandidatët aplikantë në testimin e informatizuar të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e Mjekësisë dhe Stomatologjisë, ju bëjmë me dije se testimi do të zhvillohet në datat **23, 24 dhe 25 Prill 2025**, në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish ATSH).

Kalendari dhe listat emërore me orarin për çdo grup, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së **30 minuta përpara** orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:
 - Mjet identifikimi (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
 - Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
 - Faturën origjinale të pagesës së tarifës së testimit, të kryer për llogari të QSHA-së në një bankë të nivelit të dytë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së, <https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/>)

** Vëmendje: fatura duhet të ketë vulën e bankës përkatëse.*

Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk mund të marrin pjesë në testim.

2. Kandidati duhet të mbajë parasysh sa më poshtë:
 - Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
 - Ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
 - Ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
 - Ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit.

Orari i pjesëmarrjes në testim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Lutemi që kandidatët të verifikojnë paraprakisht të dhënat në listat emërore që do të publikohen në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al dhe në rast pasaktësish t’i drejtohen Fakultetit përkatës.

Ju urojmë Suksese !